



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

RELACION SHPJEGUES

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2020, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

Qëllimi 1 – Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykatë, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.

Ky qëllim është përmbushur në masën 100%.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetëse për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur tre objektiva për realizim, si më poshtë:

1. ***Objektivi 1.1*** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja të 16 fëmijëve gjatë periudhës Janar-Gusht 2020. ***Ky objektivi është përmbushur plotësisht.*** Për periudhën raportuese, janë parashikuar për t'u realizuar 16 birësime, të cilat janë realizuar 100%.
2. ***Objektivi 1.2*** – Blerje pajisje elektronike.

Ky objektivi parashikohet të realizohet në muajin Shtator 2020. Realizimi i tij është shtyrë në kohë për shkak të pezullimit të përkohshëm të procedurave të prokurimit nga APP për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

3. ***Objektivi 1.3*** – Blerje pajisje zyre.

Ky objektivi parashikohet të realizohet në muajin Shtator 2020. Realizimi i tij është shtyrë në kohë për shkak të pezullimit të përkohshëm të procedurave të prokurimit nga APP për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objektivi, situata paraqitet si në vijim:

Objektivi 1.1 ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti A – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. *Ky produkt është përmbushur në masën 100%.*

Sasia (sipas planit 8/mujor)	16
Sasia (sipas planit të rishikuar 8/mujor)	16
Sasia faktike (në fund të 8/mujorit të vitit 2020)	16
Shpenzimet (sipas planit 8/mujor)	10.140.000 lekë
Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 8/mujor)	9.140.000 lekë
Shpenzimet faktike (në fund të 8/mujorit të vitit 2020)	5.525.286 lekë
Kosto/njësi (sipas planit 8/mujor)	633.750 lekë
Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 8/mujor)	571.250 lekë
Kosto/njësi faktike (në fund të 8/mujorit të vitit 2020)	345.330 lekë

Shpenzimet për këtë produkt janë përballuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2020. Kosto/njësi për kërkesat e shqyrtuara është më e ulët se vlera e parashikuar në momentin e planifikimit buxhetor për shkak të uljes së shpenzimeve faktike korrente: konkretisht, në llogarinë ekonomike 600 dhe 601, pasi struktura e institucionit gjatë gjithë periudhës raportuese ka qënë e paplotësuar, gjë që sjell uljen e shpenzimeve faktike për këto artikuj kontabël; si dhe shpenzimet faktike për llogarinë ekonomike 602 kanë qënë më të ulëta se vlera e parashikuar e tyre, pasi janë ulur shpenzimet për shërbime nga të tretët, si dhe procedurat e prokurimit të parashikuara për këtë periudhë nuk janë realizuar të gjitha për shkak se Agjencia e Prokurimit Publik përkohësisht ka pezulluar përkohësisht zhvillimin e procedurave që nuk lidhen drejtëpërdrejtë me infeksionin COVID-19. Po ashtu, edhe pagesat për honorare bordi janë realizuar në masë më të vogël se vlera e parashikuar e tyre.

Sa i takon 2 (dy) produkteve të tjera: pajisje elektronike të blera dhe pajisje zyre të blera, realizimi i tyre brenda 8-mujorit 2020 është shtyrë për shkak të pezullimit të procedurave të prokurimit nga APP në kushtet e pandemisë nga COVID-19. Në vijim, në muajin Gusht 2020 kanë nisur procedurat për blerjen e pajisjeve që nevojiten dhe procedurat parashikohen të përfundojnë në muajin Shtator 2020.

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar-Gusht 2020, KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Pavarësisht situatës së pandemisë globale, institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, si dhe realizimi i proceseve birësuese brenda dhe jashtë vendit duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

Gjatë periudhës Janar-Gusht 2020, është monitoruar vazhdimisht buxheti i miratuar dhe në kushtet e përhapjes së infeksionit COVID-19, janë raportuar pranë Ministrisë së Drejtësisë si fonde të lira 150.000 lekë në llogarinë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime), të cilat janë pakësuar nga buxheti ynë me Aktin Normativ Nr.6, datë 21.03.2020. Po ashtu, me Aktin

Normativ Nr.28, datë 02.07.2020 janë pakësuar 1.000.000 lekë nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime). Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar fondin e veçantë prej 100.000 lekë për vitin 2020.

Realizimi i llogarive ekonomike për periudhën raportuese, paraqitet si në vijim:

	Totali	Llog. 600	Llog. 601	Llog. 602	Llog. 606	Llog. 231
Buxheti (PLAN)	11,140,000	5,700,000	1,020,000	2,320,000	100,000	2,000,000
Buxheti (FAKT)	5,525,286	3,442,184	571,715	1,511,387	0	0
Perqindja e realizimit	49.60%	60.39%	56.05%	65.15%	0.00%	0.00%

- Diferencat në realizim në llogarinë ekonomike 600 (Paga) dhe 601 (Sigurime shoqërore) vijnë si pasojë e strukturës organike të paplotësuar të institucionit, ku paraqiten vakant 3 (tre) pozicione: pozicioni Specialist (Shkenca sociale) – me kategori page IV-a, pozicioni Specialist (Psikolog) – me kategori page IV-a, si dhe pozicioni Specialist (Jurist) – me kategori page IV-a.
- Sa i takon llogarisë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) ka diferenca të mëdha duke qënë se nuk janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit të parashikuara gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2020, pasi në zbatim të njoftimeve të publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni COVID 19, janë pezulluar shpalljet e procedurave të reja të prokurimit publik. Nga ana tjetër, edhe fondet e parashikuara për shërbime nga të tretët, si dhe për zërin honorare për anëtarët e Këshillit Drejtues të KSHB nuk janë realizuar në masë të plotë gjatë periudhës raportuese.
- Po ashtu, fondi prej 100.000 lekë miratuar në llogarinë ekonomike 606 (Transferta për buxhete familjare ose individë) nuk është shpenzuar pasi nuk kanë ndodhur rrethanat për realizimin e tij (raste të situatave të vështira, dalje në pension etj).
- Lidhur me fondet e investimeve në llogarinë ekonomike 231 (Investime kapitale të brendshme), në muajin Gusht 2020 kanë filluar procedurat për prokurimin e pajisjeve të zyrës dhe elektronike, blerja e të cilave parashikohet të përfundojë në muajin Shtator 2020.

Theksojmë se, gjatë periudhës Janar-Gusht 2020, për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fonde nga Buxheti i Shtetit.

Sa i takon treguesve të performancës, situata paraqitet:

Tregues performance në nivel qëllimi:

1. Përqindja e rasteve të birësimeve të sukseshme ndaj totalit të birësimeve – Parashikimi 100% / Realizimi 100%.

Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht.

Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektiv janë realizuar plotësisht.

Në përfundim, sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë objekt investimi me financim të huaj. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe si rrjedhojë nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash. Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar-Gusht 2020 janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit.

HARTOI:
SPECIALIST (FINANCE)
Selma Ago

MIRATOI:
KRYETAR
Denada Seferi